# DËSHMI ARKIVI

**A-441220**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Daniel Maldini, pozitiv në testin e alkoolit, i hiqet patenta pas aksidentit |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/13/daniel-maldini-pozitiv-ne-testin-e-alkoolit-i-hiqet-patenta-pas-aksidentit/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 19:32:34 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 13 shtator 2026, 19:24:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 13 shtator 2026, 19:23:00 UTC → 13 shtator 2026, 19:25:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `169322a04c7963eb51038e650ec35a89c8f8a2de5734833654bb2c84808a0dde` |
| TEKSTI | `bd000ce8c16746a14e58ac1b49265241e0e0423984e159c29a85e6d549db224b` |
| PAMJA | `e3cf35d9b58510c851f6732cb3a24300a189957e2ee5dc3fbe25ccbdb91afa93` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `7e14bf5e944a1c128d63235a85d912045214a2ac1a6db4cd14b6fad2fc98ee0e` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/7e14bf5e944a1c128d63235a85d912045214a2ac1a6db4cd14b6fad2fc98ee0e`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Daniel Maldini, pozitiv në testin e alkoolit, i hiqet patenta pas aksidentit

13/09/2026 21:24




**Daniel Maldini rezultoi pozitiv në testin e alkoolit me futbollistin që iu hoq edhe patenta pas aksidentit të pësuar me makinën e tij mëngjesin e kësaj të diele në Milano.**

Futbollisti i Cagliarit regjistroi vlera 0.91 mg/l në testin e parë dhe 0.89 mg/l në të dytin, teste këto të kryera në vend nga policia lokale. Tani nga spitali priten rezultatet e testeve të tjera për të verifikuar nëse ka edhe gjurmë të lëndëve narkotike.

**Çfarë do të thotë 0.91 mg/l?**

Një vlerë prej 0,91 mg/l në testin e alkoolit korrespondon me një përqendrim të alkoolit në gjak prej 1,82 g/l. Sipas Kodit Rrugor italian (neni 186), një vlerë prej 1,82 g/l përfshihet në fashën e tretë dhe më të rëndë të veprës penale (mbi 1,5 g/l). Bëhet fjalë për një shkelje me karakter penal, për të cilën parashikohet pezullimi i lejes së drejtimit për një periudhë nga 1 deri në 2 vjet, si dhe sekuestrimi dhe konfiskimi i automjetit.

**Dinamika e aksidentit**

Sipas Policisë Lokale, Daniel Maldini ishte në drejtimin e një makine të tipit Porschr Carrera 4 dhe hyri në rrugën  Caracciolo nga rruga Tolentino pa i dhënë përparësi një makine Golf që po shkonte në drejtim të rrugës Mac Mahon. Pjesa e përparme e makinës së futbollistit të Cagliarit goditi makinën tjetër që u përplas me një Mercedes të parkuar në rrugën Caracciolo

**Të lënduarit**

Në vendngjarje ndërhynë 3 ambulanca dhe një automjet mjekësor: Maldini u dërgua me kodin blu në Fatebenefratelli, ndërsa të lënduarit u transportuan me kod portokalli në Poliklinikë në San Carlo dhe në Fatebenefratelli. 'Pas një ekzaminimi në kodin blu pranë ndihmës së shpejte, Daniel Maldini doli menjëherë dhe u kthye në banesën e tij dhe është në gjendje të mirë shëndetësore-është shprehur përmes një komunikate avokati i Daniel Maldinit,  Danilo Buongiorno-Daniel është mirë dhe nuk ka pësuar asnjë lloj lëndimi'.

**Top Channel**

## Futboll »





## SPORT • KRYESORE



Renditja/ Elbasani i bën "nder" Teutës, durrsakët kryesojnë të vetëm, Vllaznia në krizë të thellë. Si paraqitet situata në Superiore pas javës së katërt



Kaos në Kurbin, Vllaznia mbetet me 10 lojtarë, arbitri zbraz stadiumin, Laçi përfiton dhe merr 3 pikët



Formula 1/ Antonelli është i pandalshëm, italiani triumfon në Madrid dhe sheh titullin kampion t'i afrohet akoma më shumë



Barcelona dhuron sërish spektakël, mund Levanten dhe ruan me pikë të plota kreun e La Ligës



Ekskluzive/ "S'kam gjë nga zemra, por...", rrëfimi shokues i Lorenc Trashit pas tmerrit në fushë

## ME TË LEXUARAT

Serbia e kishte kapiten, Kosova e mori, Lille i hapi derën, si u shua karriera e Arton Zekajt

"Ky nuk është më futboll", Ronaldo shpërthen ndaj tifozëve të Al-Taawoun: Të ndalohen përgjithmonë

Na ndiqni:

Top Channel | Top Channel - Sport | @topchannelalbania | Top Channel

## Video »



Top News- Kosova me Qeveri të re! Albin Kurti votohet kryeministër për herë të katërt



Top News- Tensionet Athinë-Ankara, Mitsotakis mesazh Turqisë: Duam dialog, por s'pranojmë kërcënime



Top News- Shtëpi bari me agjent imobiliar! Dënohet drejtori në Angli, u gjeti 19 shtëpi shqiptarëve



Kryqi i Fjalës- Arben Cejku – Vitrina e Librit



Top Channel/ Berzh: Bashkitë të përthithin projekte, Zielinski për TCH: Për integrimin Shqipëria...



Top Channel/ Dokumentari për jetën e publicistit që la gjurmë në media, sonte në "exclusive"



© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.